



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 8749 Prot
2

Fier më, 31 /07 /2025

PROCES VERBAL

Mbledhja e Këshillit të Bashkisë datë 31.07.2025. Sot në sallën e mbledhjeve ora 10:00. Të pranishëm në mbledhje 29 këshilltarë.

Znj. Antoneta Çunaj

Përhëndetje të gjithëve ! Fillojmë mbledhjen e këshillit bashkiak, meqënëse kuorumi është arritur.

Pika e parë e rendit të ditës.

Miratimi i rendit të ditës.

Znj. Antoneta Çunaj

Materialet ju kanë ardhur të gjithëve në mënyrë elektronike. Përsa i takonit rendit të ditës, kemi dy ndryshime. Pika 5 e tij, nuk do të jëtë në formën e projektvendimit, por në formën e propozimit, për ti hapur rrugën procesit të emërtesës së shkollave të bashkuara, pasi ka mbaruar e gjithë procedura administrative, është bërë edhe dëgjesa publike, ku pjesmarrësit kanë rënë dakort me propozimin e emërtesavë të bëra nga ZVA Fier për këtao dy shkolla të bashkuara, pra për ti hapur rrugën që mbledhjen e ardhëshme të merret një vendim për emërtesën e këtye dy shkollave të bashkuara..Kurse pika 7 e tij është tërhequr nga administrata për plotësim dokumentacioni.

Znj. Evis Sema.

Ju lutem mund të bëjë një propozim për të shtuar një pikë në rendin e ditës. Bëhët fjalë për të ndihmuar sado pak financiarisht, në trjatinin e shtetases Enada Merkaj, e cila vuan nga një sëmundje e rëndë sikurse është ajo e leuçemisë, dhe ka nevojë për kura të shtrenjta dhe trajtim të specializuar. Kërkesa për ndihmë është paraqitur nga i ati i vajzës, pranë zyrës me një ndalesë në bashki dhe ka ardhur edhe pranë sekretarisë së këshillit bashkiak. Ju faleminderit !

Znj. Antoneta Çunaj

Në sekretarinë tonë, përveç propozimit të anëtares së këshillit znj. Evis Sema, kanë ardhur edhe dy projektvendime për dhënie ndihme shtetërore financiare për shtetasit Panajot Gjika dhe Isuf Kajolli për djegjen e banesave të tyre nga zjarri. Këto materiale kanë ardhur pas publikimit të rendit të ditës dhe mbledhjes që kemi bërë ne si Kryesi. Pra jeni dakort që Rendi i Ditës të jetë me ato që parashtrova më sipër , duke futur edhe këto tre shtesat. Kush është dakort ?

Miratohen pikat e rendit të ditës.

Pro 29 vota.

Kundra s'ka

A

//

✓

✓

✓

✓

Abstenim s'ka

Miratohet me të gjitha votat pro.

Pika e dytë e rendit të ditës.

Miratimi i pocesverbalit të mbledhjes së këshillit të datës 23.06.2025

Antoneta Çunaj

Ky procesverbal i mbledhjes është firmos sipas ligjit .

Z.Armando Çupa

Procesverbali ju është dërguar dhe elektronikisht përmes e-mailit të gjithë kryetërëve të grupeve si zakonisht.

Antoneta Çunaj

Kush është dakort me miratimin e pikës dy të rendit të ditës?

Pro 29 vota.

Kundra s'ka

Abstenim s'ka

Miratohet me të gjitha votat pro.

Pika e tretë e rendit të ditës.

Projekt vendim” Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% për muajin qershor 2025”

Znj.Suela Prifti

Përsëndetje të gjithëve!Për muajin qershor, nga fondi i kushtëzuar 6% gjithësej 36 familje me një fond prej 177,322 (njqind e shtatedhjete e shtatemije e treqind e njezete e dy) dhe nga skema e ndihmës ekonomike hiqen 15 familje, për shkak se kanë disa muaj që kanë përfituar nga kjo skemë dhe për verifikim të gjendjes së tyre financiare dhe ekonomike të tyre, dalin për momentin nga kjo skemë e ndihmës ekonomike. Ndërkohë që janë futur 3 familje të reja, një nga Rajoni nr.1, një nga Rajoni nr.3 dhe një nga Nj.A Mbrostar

Antoneta Çunaj

A është mbledhur komisioni përkatës për këtë projekt vendim?Po? A është kryetari i komisionit?

Z.Elvi Daka

Përsëndetje të gjithëve!Komisioni ka diskutuar përmes një diskutimi të hapur pasi nuk formojë kuorumi për mbledhjen e tijë, pasi shumica e këshilltarëve në këtë periudhënë kanë qënë të angazhuar me punë dhe me pushime. Nga ana e të pranishëmve nuk ka patur propozime për ndryshimin e këtij projekt vendimi.

Antoneta Çunaj

Dëshiron dikush tjetër fjalën në lidhje me këtë pikë?Nuk ka diskutime.E hedhim në votim.

Pro 29 vota.

Kundra s'ka

Abstenim s'ka



Miratohet me të gjitha votat pro.

Pika e katërt e rendit të ditës.

Projekt vendim për “Miratimin e Tavanëve Përfundimtare të Shpenzimeve të Buxhetit Afatmesëm Vendor 2026-2028 të Bashkisë Fier”

Znj.Pranvera Cina

Në lidhje me projekt vendimin, dua t’ju informoj se bashkia Fier nuk ka bërë ndryshime si në parashikimin e të ardhurave ashtu edhe në transfertën e pakushtëzuar. Kjo bazuar në Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8 datë 28.02.2025, “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028”. Për rrjedhojë dhe tavanet përfundimtare nuk do të kenë asnjë ndryshim nga tavanet e miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.30 datë 27.03.2025 “Për Miratimin e Raportit për Vlerësimin

dhe Parashikimin Afatmesëm të të Ardhurave 2026-2028 të Bashkisë Fier”. Gjithashtu është mbledhur dhe komisioni përkatës për këtë projekt vendim, është diskutuar. Nuk kemi asnjë lloj ndryshimi për këtë projekt vendim.

Antoneta Çunaj

Dëshiron ndonjë nga këshilltarët të flasi në lidhje me këtë projekt vendim?Komisioni është mbledhur?

Znj.Erlinda Tavanxhiu

Komisioni përkatës është mbledhur ditën e djeshme dhe ka konkluduar për ta kaluar për miratim në këshill.

Antoneta Çunaj

A do ndonjë këshilltarë fjalën?

Z.Endri Jaupaj

Është mbajtur nga ana e komisionit procesverbal për këtë mbledhje?Është diskutuar apo thjeshtë është votuar?

Znj.Erlinda Tavanxhiu

Po është mbajtur procesverbali nga ana e komisionit. Kishte diskutime por në fund u vendos të kalojë për miratim pasi nuk kishte ndryshime nga ajo që ishte miratuar me VKB e mëparëshme të këshillit bashkiak.

Z.Endri Jaupaj

Dmth u miratua nga të gjithë?

Znj.Erlinda Tavanxhiu

Po,po.

Antoneta Çunaj

Diskutime të tjera nuk ka kështu që e hedhim në votim.

Pro 28 vota.

Kundra 1 votë

Abstenim s’ka

Pika e pestë e rendit të ditës.

Propozim "Për emërtimin e shkollave të bashkuara "Jovan Ndreko" dhe "Dino Ismili"

Antoneta Çunaj

Pika e pestë e rendit të ditës është një propozim për emërtimin e shkollave të bashkuara në Levan dhe Libofsh dhe kjo bëhet për ti hapur rrugë në mbledhjen e radhës vendim marrjes në lidhje me këtë çështje. Janë bërë dëgjuesat publike dhe pjesëmarrësit kanë rënë dakort me këto emërtesa, është thjeshtë për fillimin e procedurës.

Z.Gëzim Hajdëraj

Këshilli nuk merret me propozime. Këshilli merr vendime. Po është propozim nuk ka nevojë që të kalojë në këshill.

Znj.Eleni Gjikonaj

Më fal, kryetare. M.q.s të gjitha procedurat administrative duke përfshirë dhe dëgjuesat publike janë kryer, unë mendoj që nëse këshilltarët siç u shpreh dhe Z.Hajdëraj janë të gatshëm, atëherë le të marrin vendimin për emërtesën e shkollave që në këtë mbledhje

Antoneta Çunaj

Nëse nuk doni që këtë propozim ta kalojmë në këshill, dakort.

Znj.Suela Prifti

T'ju sqaroj diçka. Nga e bashkisë është bërë një dëgjuesë publike, mqs na ka ardhur një kërkesë nga ana e ZVAP-Fier në të cilën kërkohej emërtesa e bashkimit të shkollave. Nga ana e ZVAP-Fier është kryer procedura e bashkimit të shkollave, bëhet fjalë për bashkimin gjimnazit "Jovan Ndreko" në Libofsh dhe shkollës 9-vjeçare "Anastas Laska" po aty, për të krijuar një shkollë të bashkuar. Këto dy institucione arsimore ndodhen brenda të njëjtit oborr por ndodhen në godina të ndryshme. Shkolla "Anastas Laska" ka 131 nxënës dhe ka 14 mësues, ndërsa gjimnazi "Jovan Ndreko" ka 64 nxënës dhe 8 mësues. Për këtë arsye ZVAP-Fier kërkon bashkimin në një shkollë për këto dy institucione që sapo folëm. Ndërkohë që mqs nga dëgjuesat publike që u organizua u arrit në përfundimin që shkolla e bashkuar të mbajë emrin "Jovan Ndreko" mqs është dhe shkolla më e hershme në zonën e Libofshës. Nqs nga këshilltarët, përfaqësues të zonës së Libofshës ka ndonjë sygjërim apo propozim tjetër jemi të hapur ta dëgjojmë.

Z.Elvi Daka

Nqs e keni në kuadër diskutimi dua të konfirmoj diskutimin publik që u bë me komunitetin e kësaj zone për emërtesën e shkollës së bashkuar mqs për shkak të ndryshimit të numrit të nxënësve duhet të bëhet një shkollë e bashkuar dhe këto dy shkolla duhet të kenë vetëm një emërtim, është pranuar nga komuniteti që emri i kësaj shkolle të bashkuar të jetë "Jovan Ndreko" për shkak të historikut më të hershëm por edhe për shkak të kontributit të këtij mësuesi në zonën e Libofshës. Kështu që nqs ne do të marrim vendimin që të pranojmë propozimin patjetër që ne jemi dakort me këtë emërtesë.

Znj.Evisa Sema

Të sqaroj diçka se po keqkuptohet. Vendimin për të bashkuar dy shkollat është një procedurë që e merr ZVAP. Ne vetëm emërtimin e shkollës së bashkuar mund të bëjmë. Nga dëgjuesat publike është marrë

vendimi për emrin e shkollës së bashkuar që të jetë “Jovan Ndreko”. Këta këshilltarë nga Libofsha apo nga zonat përreth kanë qënë prezent në dëgjuesën publike ku është diskutuar dhe është vendosur për këtë emërtesë të shkollës së bashkuar.

Znj.Eleni Gjikonaj

E njëjta procedurë është ndjekur dhe për shkollat e Levanit.

Znj.Suela Prifti

Për bashkimin e gjimnazit “Kutbi Vruzhaj” me shkollën 9-vjeçare “Dino Ismaili” Duke qënë se gjimnazi si godinë nuk ekziston është parë e arsyeshme që emërtimi i shkollës së bashkuar të mbajë emrin me emrin e shkollës 9-vjeçare “Dino Ismaili”.Nr i nxënësve në këto shkola është përkatësisht gjimnazi 44 nxënës dhe 5 mësues kurse në shkollën 9-vjeçare “Dino Ismaili” janë 236 nxënës dhe 18 mësues.Duke qënë se shkolla “Dino Ismaili” është më e vjetër si shkollë dhe nga dëgjesa publike ranë dakort që emërtesa e shkollës së bashkuar të jetë “Dino Ismaili”

Z.Gëzim Hajdëraj

Ne vendosim për emrat e shkollave?

Znj.Antoneta Çunaj

Nuk vendosim ne për emrat e shkollave. Është bërë dëgjesa publike dhe kanë ardhur propozimet përkatëse dhe ne jemi të detyruar të marrim vendim.

Z.Gëzim Hajdëraj

Kjo procedurë është nomeklaturë e drejtorisë arsimore apo është nomeklaturë e këshillit sepse nuk jam i qartë.

Znj.Antoneta Çunaj

Emërtesa e shkollave është e këshillit.

Z.Gëzim Hajdëraj

Atëherë ne duhet të marrim një vendim sot.

Z.Kreshnik Dapi

Materialet kanë ardhur, janë shumë të qarta dhe shpjegimi jua është shumë i qartë. Ne sot i hapim rrugë procesit.

Znj.Antoneta Çunaj

Unë mendoj që duhet të jetë edhe nënshkrimi i drejtoreshës së ZVAP-Fier në procesverbalin e dëgjuesës publike. Mometalish ajo nuk ndodhet në Shqipëri.

Znj.Esmeralda Kapllanaj

Për sa i përket bashkimit të shkollave ajo është një anë procedurale që e ka ndjekur ZVAP-Fier, ne nuk kemi punë me këtë proces.Nga ana jonë është kryer shpallja dhe është bërë dëgjesa publike në

bashkëpunim me ZVAP-Fier, këshilli ka përfaqësuesit e tij të këtyre zonave që sikurse u tha kanë qënë prezent në këto dëgjesa.

Z.Kreshnik Dapi

Ai është një fenomen që procesi duhet të ndodhi sepse kjo ardhur si rezultat i një nevoje. Në dokumentat, kush ka lexuar materialin çdo gjë është sqaruese. Ne si këshill e kemi tagër pjesën e emërimit të shkollave. Unë mqs doli ky problem kam një pyetje: Me mësuesit ç'farë do të ndodhi?

Znj.Antoneta Çunaj

Këtë pjesë e ka në nomenklaturë ZVAP-Fier. Ne si këshill nuk merremi me organikën e mësuesve. Atëherë pasi dëgjuat gjithë sqarimet a jeni dakort që në bazë të kërkesës së ZVAP-Fier dhe propozimit që ka ardhur nga dëgjesat publike të kalojmë në vendim marrje për emërtesën e shkollave të bashkuara?

Me kaq mbledhjen e deklarojë të mbyllur. Ju falenderojë të gjithëve për pjesëmarrjen !

Pro 29 vota.

Kundra s'ka

Abstenim s'ka

Miratohet.

Z.Endri Jaupaj

Bëmë gjithë këtë diskutim këtu dhe kaluam miratimin e tavaneve të buxhetit 2026-2028 pa bërë asnjë diskutim dhe u morëm me erinin e shkollës për gjithë këtë kohë, nuk ka mundësi kjo gjë?

Znj.Antoneta Çunaj

Unë ua dhashë fjalën të gjithëve kur ishte ajo pikë. Ti nëse kishe diçka për të folur flisje, pse nuk fole?

Z.Kreshnik Dapi

Për pjesën e shqetësimit që po thotë Endri. Unë si anëtarë i komisionit të ekonomisë, edhe Z.Arben Çuko edhe zonha që mori fjalën, kemi zhvilluar mbledhje të rregullta të komisionit ku kanë qënë prezent edhe drejtuesit përkatës të administratës si Z.A.Behari dhe Znj.P.Cina. Kemi parë gjithë dokumentacionin përkatës, kemi hartuar raportin e komisionit dhe kemi dëgjuar shpjegimet e ekzekutivit dhe çdo gjë ka qënë në rregull.

Z.Endri Jaupaj

Z.Dapi, nuk kam asnjë vërejtje në lidhje me këto që thoni ju, por unë që nuk kam qënë pjesë e këtij komisioni do të doja të dëgjoja për atë pikë të rendit të ditës shpjegime të detajuara nga administrata të cilat nuk i dëgjova.

Znj.Antoneta Çunaj

Z.Jaupaj, unë kur trajtova atë pikë të rendit të ditës, jua dhashë fjalën të gjithë anëtarëve të këshillit që donin të flisnin. Ju aq folët.

Z.Endri Jaupaj

Unë po them që ekzekutivi tha vetëm një fjali. Për mua nuk mund të kalohej ky projekt vendim vetëm me një fjali.

Znj. Antoneta Çunaj

Atë pikë e kemi kaluar. Kalojmë tek pikat e tjera të rendit të ditës.

Pika e gjashtë e rendit të ditës.

Projekt vendim: "Për trajtimin me ndihmë shtetërore financiare të familjes së shtetasit Petrit Bregu, fshati Lalar, Njësia Administrative Portëz, i dëmtuar nga zjarri i datës 12.06.2025.

Znj. Antoneta Çunaj

Komisioni është mbledhur për këtë pikë?

Z. Kreshnik Dapi

Po, komisioni është mbledhur dhe e ka trajtuar pikën gjashtë si dhe dy pikat e tjera shitesa që ju i propozuat në fillim të mbledhjes. Komisioni vendosi që ti kalojë të tre projektvendimet për miratim në këshill pasi konstatoi që i gjithë dokumentacioni i paraqitur nga drejtori Bani ishte i rregullt dhe në përputhje me ligjin.

Znj. Antoneta Çunaj

E do ndonjë tjetër fjalën? Nuk ka asnjë për diskutim e hedhim në votim. Kush është pro?

Pro 29 vota.

Kundra s'ka

Abstenim s'ka

Miratohet.

Znj. Antoneta Çunaj

Mqs pika gjashtë e rendit të ditës që sapo miratuam ka të bëjë me dëmtimet nga zjarri dhe ne shtuam në rendin e ditës edhe dy familje të tjera për tu trajtuar me ndihmë si pasoje e djegjes nga zjarri. Kemi projekt vendimin për shtetasin Panajot Gjika "Për trajtimin me ndihmë financiare të familjes së shtetasit shtetasit Panajot Gjika, fshati Seman i Ri, Njësia Administrative Topojë, i dëmtuar nga zjarri i datës 04.07.2025. Kush është dakort?

Pro 29 vota.

Kundra s'ka

Abstenim s'ka

Miratohet.

Znj. Antoneta Çunaj

Kemi gjithashtu projekt vendimin për ndihmën e djegjes nga zjarri për shtetasin Isuf Kajolloi

Projekt vendim "Për trajtimin me ndihmë shtetërore financiare të familjes së shtetasit Isuf Kajolli, lagjja "15 Tetori", Njësia Administrative nr.3, i dëmtuar nga zjarri i datës 15.07.2025.

Kush është dakort?

Pro 29 vota.

Kundra s'ka

Abstenim s'ka

Miratohet.

Znj.Antoneta Çunaj

I trajtuam të treja këto pika të rendit të ditës së bashku sepse kishin të njëjtën natyrë. Pra si pika gjashtë edhe pika 1 shtesë dhe 2 shtesë e rendit të ditës i trajtuam dhe i miratuam së bashku.

Pika shtatë e rendit të ditës.

Znj.Antoneta Çunaj

Pika shtatë e rendit të ditës është tërhequr nga administrata për plotësim dokumentacioni.

Pika tetë e rendit të ditës.

Projekt vendim "Për miratimin e shpenzimeve për dhënie ndihme të menjëherëshme financiare Znj. Juella Meta"

Znj.Antoneta Çunaj

Është mbledhur komisioni?

Z.Elvi Daka

Është rasti që është bërë edhe mediatik, komisioni është mbledhur por ashtu si edhe thashë në rastin e sipër për arsye të impenjimeve personale nuk ka patur kuorum, por është diskutur . Bëhet fjalë për një familje me 9 antarë, ku pas rënies në burg të babait, nëna tashmë me 7 fëmijët e saj është nxjerrë dhe nga shtëpia që e ka patur në ruajtje dhe është në një varfëri ekstreme dhe ka nevojë për ndihmën tonë duke patur parasysh edhe hapësirat ligjore që ne kemi për mbështetje në raste të tilla. Nuk e di nëse kemi mundësi për të shtuar diçka tjetër në lidhje me këtë rast përse i përket edhe strehimit social.

Znj.Suela Prifti

Bashkia i ka ofruar kësaj familje edhe subvencion qeraje si dhe një vend pune për kryefamiljaren., por mqs ajo ka fëmijë të vegjël nuk e ka pranuar pozicionin e punës kështu që do të mbetet bonusi i qerasë.

Znj.Antoneta Çunaj

A ka diskutime? E hedhim në votim?

Pro 29 vota.

Kundra s'ka

Abstenim s'ka

Miratohet.

Mqs jemi këtu kemi edhe pikën e tretë shtesë të rendit të ditës që ka të njëjtën natyrë si pika tetë e rendit të ditës.

Kërkesë të shtetases Enada Merkaj për dhënie ndihme financiare të menjëherëshme. Bëhet fjalë për një shtetase që është me leuçemi. Kush është dakort?

Pro 29 vota.

Kundra s'ka

Abstenim s'ka

Znj.Eleni Gjikonaj

Ju lutem specifikoheni vlerën e ndihmës për këtë shtetase në vlerën 200 mijë lekë të reja

Znj.Antoneta Çunaj

Kush është dakortë për vlerën e ndihmës financiare të menjëherëshme me vlerë 200 mijë lekë të reja?

Z.Endri Jaupaj

Nëse ka mundësi për ti dhënë më tepër jepjani.

Znj.Antoneta Çunaj

Jemi në kufijtë maksimal, nuk lejohet më tepër.

Ju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë mbledhje!

Ky procesverbal ka 9 (nëntë) faqe dhe mbahet në tre kopje nga ana e Sekretarit të Këshillit Z. Arnando Çupa.

Sekretar i Këshillit

Arnando Çupa

Kryetar i Këshillit

Antoneta Çunaj

